

PËRDORIMI
I SISTEMIT
TË PROKURIMIT
ELEKTRONIK
NË NIVEL VENDOR

RAPORT
MONITORIMI

PËRDORIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK NË NIVEL VENDOR

RAPORT MONITORIMI

Përgatitur nga Partnerët Shqipëri

Tiranë, 2015

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Tiranë, Shqipëri, 2015

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia
Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel. 04 2254881 Faks: 04 2254883
Email: partners@partnersalbania.org
<http://www.partnersalbania.org>

Ky botim u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Përgatitja dhe publikimi i tij u mundësua me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë, në kuadër të projektit "Rritja e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë në Aplikimin e Prokurimit Publik Elektronik në Nivel Vendor". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.

Partnerët Shqipëri falenderon për zemërsisht të gjithë operatorët ekonomikë të cilët bashkëpunuan në këtë studim duke ndarë eksperiencat e tyre dhe duke kontribuar me opinione e rekomandime.

Një falenderim i veçantë shkon për bashkitë e Beratit, Fierit, Himarës dhe Sarandës, në veçanti për stafin e njësive të prokurimit dhe anëtarët e komisioneve të prokurimit në këto bashki, për informacionin e ofruar dhe bashkëpunimin në kryerjen e këtij studimi.

Drejtuese

Prof.Dr. Raimonda Duka

Grupi i Vëzhgimit

Ariola Agolli
Emi Mima
Blerina Guga
Adela Bani

Grupi i Analizimit, Administrimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Prof.Dr. Raimonda Duka
Ariola Agolli
Emi Mima

ISBN: 978-9928-08-193-3

Shtypi: MediaPrint

Dizajni Grafik: Arben Hamzallari



Tabela e përmbajtjes

TABELA DHE GRAFIKË.....	6
SHKURTIMET	6
1. PËRMBLEDHJE	7
2. HYRJE	12
3. METODOLOGJIA	14
4. DISA KONSIDERATA MBI PROKURIMIN PUBLIK ELEKTRONIK DHE KUADRIN LIGJOR	16
5. GJETJET KRYESORE MBI EKSPERIENCËN E OPERATORËVE EKONOMIKË ME PROKURIMIN PUBLIK	24
5.1 KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË KAMPIONIT	24
5.2 EKSPERIENCA E OPERATORËVE EKONOMIKË ME BASHKITË	30
5.3 PROCEDURAT E ANKIMIMIT	31
5.4 INFORMACIONI MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT	33
6. GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT NË NIVEL BASHKIE	35
7. PERCEPTIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ELEKTRONIK	39
7.1 NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR	39
7.2 TRANSPARENCA E PROCEDURAVE	41
7.3 KONKURRENCA NË PROKURIMET PUBLIKE	42
7.4 APLIKIMI I KRITEREVE TË VEÇANTA	44
7.5 EFEKTIVITETI I PËRDORIMIT TË FONDEVE	47
7.6 FUNKSIONIMI I PORTALIT TË APP	47
7.7 MBËSHTETJA E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETET KONTRAKTORE DHE OPERATORËT EKONOMIKË	48
7.8 SUPERVIZIMI I PUNIMEVE	48
7.9 DISBURSIMI I FONDEVE	48
7.10 KAPACITETET E AUTORITETEVE KONTRAKTORE DHE OPERATORËVE EKONOMIKË	50
8. KONKLUSIONE	51
9. REKOMANDIME	53
10. REFERENCA	54




Tabela 1: Shpërndarje e kampionit	15
Tabela 2: Kufijtë monetarë sipas llojit të kontratave.....	22
Tabela 3: Shpërndarja e rasteve të monitoruara sipas llojit të procedurës (Janar-Dhjetor 2014) 29	
Tabela 4: Shpërndarja e rasteve të monitoruara sipas tipit të kontratës (Janar-Dhjetor 2014)....	29
Tabela 5: Arsyet për mospjesëmarrje në procedurat e prokurimeve publike	31
Tabela 6: Arsyet e mosankimimit pranë Autoriteteve Kontraktore.....	33
Grafiku 1: Shpërndarja e kampionit sipas formës ligjore të biznesit (n=60)	24
Grafiku 2: Shpërndarja e kampionit sipas veprimtarisë kryesore të biznesit (n=60)	25
Grafiku 3: Shpërndarja e kampionit sipas numrit të të punësuarve (n=60)	26
Grafiku 4: Shpërndarja e kampionit sipas numrit mesatar të procedurave në një vit (n=60)....	26
Grafiku 5: Shpërndarja e kampionit sipas eksperiencës së përgjithshme me prokurimet publike (n=60)	27
Grafiku 6: Xhiroja vjetore e kompanisë në vitin 2013 (n=60)	28
Grafiku 7: Pjesa e xhiros vjetore që realizohet nga kontratat me Autoritetet Kontraktore (n=58)28	
Grafiku 8: Eksperienca e Operatorëve Ekonomikë me bashki të tjera (n=60).....	30
Grafiku 9: Kënaqësia e Operatorëve Ekonomikë me procedurat e prokurimit publik(n=53).....	30
Grafiku 10: Hapat e ndjekura për t'u ankimuar (n=54)	32
Grafiku 11: Informacioni në lidhje me tenderat (n=60).....	33
Grafiku 12: Plotësia e informacionit që përmbahet në dokumentet e tenderit (n=60)	34
Grafiku 13: Informacioni mbi tenderat (N=60)	40
Grafiku 14: Transparenca e procedurave (n=60)	41
Grafiku 15: Barazia në tendera (n=60)	42
Grafiku 16: Procedura vs. korrupsion (n=60).....	44
Grafiku 17: Aplikimi i kriterëve të veçanta (N=60).....	45
Grafiku 18: Detyrimet e Autoriteteve Kontraktore (N=60)	49

SHKURTIMET

Agjencia e Prokurimit Publik	APP
Autoritet Kontraktor.....	AK
Njësi e qeverisjes vendore	NJQV
Operator Ekonomik	OE
Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik	OECD
Partneriteti Publik Privat	PPP
Prodhimi i Brendshëm Bruto	PBB
Prokurim Publik	PP
Partnerët Shqipëri	PSh
Sistemi i Prokurimit Elektronik	SPE
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM



PËRMBLEDHJE

Prokurimi elektronik është forma kryesore që përdoret gjerësisht në sektorin publik për të rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve nga ana e institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore. Prokurimi përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit është më i lehtë, pasi bazohet në procedura më të shpejta dhe të thjeshtuara. Ai është më pak i kushtueshëm, sepse eliminon dokumentet e tepërta shkresore dhe inkurajon rritjen e konkurrencës. Sistemi është më transparent, pasi mundëson rritjen e fluksit të informacionit, rrit shkallën e përgjegjshmërisë, dhe siguron një përdorim më eficient dhe të efektshëm të parave të taksapaguesve.

Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) u zbatua për herë të parë në Shqipëri në vitin 2008, me mbështetjen e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit. Sistemi bazohet në një aplikim në internet dhe mundëson menaxhimin elektronik të procedurave të prokurimit publik në shkallë vendi. Sistemi i Prokurimit Elektronik menaxhohet nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe mund të përdoret nëpërmjet faqes së internetit të APP-së. Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.45, datë 21.01.2009 duke filluar që nga janari 2009 të gjitha institucionet publike i realizojnë prokurimet përgjithësisht vetëm përmes SPE-së, duke eliminuar në këtë mënyrë përdorimin e procedurave të prokurimit në letër.

Gjetjet kryesore nga monitorimi i zbatimit të prokurimit publik elektronik në nivel vendor, adresojnë gjetjet më të rëndësishme mbi monitorimin e procedurave të prokurimit publik nga njësitë e qeverisjes vendore (NJQV), eksperiencës së operatorëve ekonomikë (OE) të përfshirë në këto procedura si dhe kuadrin ligjor e rregullator dhe impaktin në praktikë gjatë zbatimit të tij.

GJETJET KRYESORE

KAPACITETET DHE EKSPERIENCA E OPERATORËVE EKONOMIKË

- Operatorët ekonomikë kanë burime njerëzore të mjaftueshme për të plotësuar detyrimet kontraktuale. 53% e operatorëve ekonomikë të intervistuar punësojnë 10-49 punonjës.
- OE në përgjithësi kanë eksperiencë me prokurimet publike. Më shumë se gjysma e OE të intervistuar (60%) kanë mbi 5 vjet eksperiencë në prokurimet publike.
- OE në përgjithësi kanë eksperiencë me Autoritetet Kontraktore (AK) për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve. Kështu 38% e OE të intervistuar marrin pjesë mesatarisht në 51-100 procedura prokurimi në vit. Gjithashtu 68% e të intervistuarve kanë eksperiencë me më shumë se dy bashki në fushën e prokurimeve publike.
- Afërsisht 56% e operatorëve ekonomikë të intervistuar realizojnë mbi 51% të xhiros së tyre vjetore nga kontratat që marrin nga autoritet kontraktore.

INFORMACIONI MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

- Më shumë se gjysma e të intervistuarve përdorin si burim për të marrë informacion në lidhje me prokurimet publike, internetin.
- Pjesa më e madhe e të intervistuarve (77%) mendojnë që informacioni që jepet në dokumentet e tenderit është i plotë dhe shumë i plotë.
- Në përgjithësi OE (82%) janë dakord me mendimin që nuk është e vështirë të marrësh informacion mbi tenderat dhe të gjesh thirrjet për tendera.
- OE në përgjithësi e marrin informacionin mbi procedurat e prokurimit nga portali i APP.

PROCEDURAT E ANKIMIMIT

- OE në përgjithësi janë mosbesues për të ndjekur procedurat e ankimit, por ka dhe raste kur atyre iu mungon informacioni në lidhje me këto procedura.
- 57% e të intervistuarve janë dakord me mendimin që procedurat dhe rregullat e prokurimit elektronik në përgjithësi janë të lehta për t'u ndjekur.

TRANSPARENCA E PROCEDURAVE

- Pjesa më e madhe e të intervistuarve (75%) mendojnë që procedurat aktuale të prokurimit janë transparente dhe shumë transparente.
- Portali online i APP mundëson monitorimin e hapjes së procedurave të tenderimit për të gjitha rastet e parashikuara nga ligji. Por monitorimi i shpalljes së fituesve pas mbylljes së procedurës paraqet vështirësi, pasi një pjesë e madhe e procedurave arkivohen menjëherë pas përfundimit të tyre.
- Në platformën online nuk mund të identifikohen OE që shpallen fitues për blerjet e vogla, pasi procedura arkivohet menjëherë nga AK.
- APP së fundmi ka bërë ndryshime në platformë për të rritur transparencën ndaj publikut për procedurat e prokurimeve të realizuara. AK mund t'i shpallin tek Njoftimi i Fituesit, të gjithë operatorët ekonomikë fitues të procedurave pavarësisht nga lloji i procedurës.
- Në portalin e APP publikohen gjithashtu dy regjistra në lidhje me prokurimet: Regjistri i Parashikimeve dhe Regjistri i Realizimit të Prokurimeve.
- Arsytet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë jepen në të gjitha njoftimet e publikuara në buletinin e prokurimeve elektronike.
- 62% e të intervistuarve mendojnë që procedurat aktuale e kanë ulur disi korrupsionin dhe vetëm 24% mendojnë që ato e kanë ulur dhe e kanë ulur shumë korrupsionin.



APLIKIMI I KRITEREVE TË VEÇANTA

- 63% e OE janë dakord me mendimin që aplikimi i kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, favorizon disa OE dhe diskriminon/përrjashton shumë OE që të marrin pjesë në tender.
- Më shumë se gjysma e të intervistuarve janë dakord me mendimin që aplikimi i kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, ndikon në uljen e numrit të OE që të marrin pjesë në tender.
- Aplikimi i kriterëve të veçanta nga AK krijon barriera, pengon aksesin e barabartë dhe konkurrencën midis OE. Në raste të caktuara vendosja e këtyre kriterëve favorizon disa OE.

FUNKSIONIMI I PORTALIT TË APP

- Operatorët ekonomikë mendojnë që ndryshimet e viteve të fundit (2013-2014) për prokurimet publike kanë qenë pozitive dhe ndihmuese për OE.
- OE hasin vështirësi në përdorimin e portalit të prokurimeve, vështirësi që lidhen kryesisht me ngarkesën e madhe në orët e fundit të mbylljes së procedurave, vështirësi në shkarkimin e formularëve apo ngarkimin e dokumenteve të tenderit.
- Sipas AK numri i kontaktit që APP ka venë në dispozicion për klientët nuk funksionon gjithmonë dhe stafi i APP nuk është disponibël për të asistuar online stafin e AK.
- Monitorimi përmes platformës së e-prokurime paraqet disa vështirësi, pasi një pjesë e procedurave arkivohen menjëherë pas përfundimit të tyre dhe për publikun nuk ka akses në arkivin e faqes.
- Në portalin e APP mundësohet gjetja e njoftimeve për kontratat e lidhura nga Autoriteti Kontraktor dhe njoftimi i fituesit, por arkivimi i shpejtë i procedurave e vështirëson marrjen e informacionit pas shpalljes së fituesit. AK duhet të publikojnë këtë informacion në faqen e internetit, për të rritur transparencën me publikun.

KONKURRENCA NË PROKURIMET PUBLIKE

- Një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve janë disi dakord që procedurat aktuale të prokurimit sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit (40%) dhe që dhënia e tenderave publikë është një proces i drejtë dhe jo-diskriminues (42%).
- 1/3 e të intervistuarve janë disi dakord me mendimin që autoritetet kontraktore vazhdojnë të lidhin kontrata të drejtpërdrejta të cilat janë të vështira për t'u sfiduar nga ofertues të mundshëm.
- Konkurrenca në procedurat "Procedurë e hapur" dhe "Kërkesë për propozim" mbetet e ulët. Në të gjitha bashkitë konstatohen raste kur kontratat për punë, mallra dhe shërbime, fitohen nga e njëjta kompani. Ndërsa konkurrenca në

procedurat “Blerje me vlerë të vogël” është më e madhe dhe numri i OE që marrin pjesë në këto procedura është i madh.

- Pjesëmarrja e OE në procedurat e prokurimit publik ndryshon sipas bashkive dhe natyrës së kontratës. Konkurrenca në bashkitë që ndodhen larg qendrave të mëdha është shumë e ulët.
- Numri i ulët i firmave pjesëmarrëse ndikon dhe në termat financiarë të prokurimeve publike. Në pjesën më të madhe kursimi nga fondi limit për të gjitha procedurat e hapura apo kërkesë për propozim është luhatur nga 0.1% deri në 3%.
- Në listën e firmave fituese konstatohen dhe raste kur firmat kontrahohen disa herë për shërbime apo mallra të ngjashme.
- Në disa raste bashkitë kanë hapur disa procedura për blerjen e të njëjtit mall ose mallrave të ngjashëm, për të respektuar limitin e vendosur për blerjet me vlerë të vogël.

EFEKTIVITETI I PËRDORIMIT TË FONDEVE

- Përgjithësisht konstatohet që kursimet e fondit limit si rezultat i prokurimeve në kontratat për punë janë në vlera minimale, madje ka dhe raste kur ato janë nën 1%. Ndërkohë që ka dhe raste sidomos në blerjet e vogla ku nuk kemi fare kursime apo kursimet janë mbi 30%.
- Në përgjithësi vlera e kontratave për supervizimin e punëve publike është shumë më e ulët sesa fondi limit. Ky fakt konstatohet në të gjitha bashkitë dhe në pjesën më të madhe të rasteve oferta e OE nuk mbulon kostot që ata kanë për mbikqyrjen e punimeve.
- Kursimi i fondit limit ndryshon në varësi të tipit të kontratës. Kursimet më të mëdha janë në kontratat për shërbime. Ato variojnë nga 1 deri në 90.2%. Në procedurat e hapura, kursimi nga fondi limit varion nga 1.9 deri në 19.5%.





2 HYRJE

RRETH RAPORTIT të monitorimit

Ky raport u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë, në kuadër të projektit “Rritja e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë në Aplikimin e Prokurimit Publik Elektronik në Nivel Vendor”, zbatuar gjatë periudhës Nëntor 2013 – Prill 2015.

Raporti bazohet në një studim të të dhënave të mbledhura nga monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të procedurave të prokurimit publik në nivel vendor, përkatësisht në Bashkitë Berat, Fier, Himarë dhe Sarandë, si dhe përvoja e operatorëve ekonomikë dhe stafit të njëjësive dhe komisioneve të prokurimit në bashki. Përzgjedhja e njëjësive të qeverisjes vendore të cilat morën pjesë në këtë projekt dhe proces monitorimi, u bë mbi bazën e një procedure aplikimi të hapur ku vetë bashkitë shprehën interesin e tyre për bashkëpunim dhe përfshirje në këtë proces. Përzgjedhja e tyre u bë mbi bazën e disa kritereve si madhësia e shtrirja e NJQV, numri i personelit, procedurat e prokurimit publik që realizonin mesatarisht në një vit etj., me qëllim identifikimin e problematikave dhe marrjen e mendimit nga njësi me karakteristika dhe eksperiencia të ndryshme.

Monitorimi shërbeu për të vlerësuar transparencën e procesit, aksesin e OE për të marrë pjesë në këto procedura dhe perceptimin e tyre në lidhje me mundësinë që krijojnë këto procedura për akses të barabartë, rritjen e transparencës, rritjen e konkurrencës, efektivitetin dhe rolin që kanë luajtur këto procedura për uljen e korrupsionit.

Projekti është vijim i punës së PSh dhe kontributit në zhvillimin e demokracisë e qeverisjes së mirë në vend, fuqizimit të institucioneve e rritjes së aksesit të publikut e grupeve të interesit në informacion. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti, synojnë të kontribuojnë në marrjen e masave konkrete nga autoritetet përkatëse si dhe në avancimin e kuadrit ligjor e rregullator, me qëllim rritjen e transparencës dhe efektivitetit të përdorimit të prokurimit publik elektronik në nivel vendor.

MIRËNJOHJE dhe Falënderime

Raporti i Monitorimit është përgatitur në bashkëpunim dhe me mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore, operatorëve ekonomikë dhe ekspertëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen kryetarëve të Bashkive të përfshirë në këtë proces, përfaqësuesve të njësive dhe komisioneve të prokurimit pranë këtyre bashkive, administratorëve dhe përfaqësuesve ligjorë të kompanive të biznesit të përfshirë në këtë raport monitorimi duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e përkushtuar. Kontributi i tyre bëri të mundur realizimin e këtij raporti.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë për mbështetjen në zbatimin e kësaj përpjekje monitoruese.





METODOLOGJIA

Procesi i monitorimit u realizua gjatë periudhës Janar 2014 -Mars 2015. Partnerët Shqipëri përgatiti dhe përdori një set mjetesesh metodologjike me qëllim monitorimin e zbatimit korrekt të Ligjit të Prokurimit Publik dhe procedurave të prokurimit elektronik për tenderat publikë në katër bashki pilot: Bashkinë Berat, Fier, Himarë dhe Sarandë.

Përqsasja metodologjike e ndjekur paraqitet si më poshtë:

- (i) Rishikim/Hulumtim literature. Duke marrë në konsideratë natyrën specifike të studimit dhe ndryshimet ndër vite të legjislacioni shqiptar mbi prokurimin publik, hulumtimi përfshiu ligje e akte nënligjore si dhe kuadrin rregullator të institucioneve që kanë rol kryesor në zbatimin e tij. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit për prokurimin publik në Nëntor 2006, disa ndryshime ligjore dhe akte nënligjore kanë pasuar në vitet në vijim. Veçanërisht në dy-tre vitet e fundit një seri Vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimesh janë miratuar e venë në zbatim. Disa nga këto ndryshime dhe konsiderata mbi to, paraqiten në këtë raport studimi.
- (ii) Analizë të dhënash nga hulumtimi dhe monitorimi on-line i faqes së internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të bashkive të përfshira në studim. Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014, u monitorua mbi baza të rregullta faqja e internetit e APP, e bashkive të përfshira në projekt, si dhe buletinët e prokurimeve publike, për të monitoruar njoftimet e publikuara për tendera në katër bashkitë në monitorim, njoftimet e fituesit, informacione mbi realizimin e prokurimeve, kontratave të lidhura, rastet e anulimeve dhe arsyet e anulimit, rastet e ankimimeve, fondin e kontratës etj.
- (iii) Studim përmes kampionimit. Kampioni i studimit ishin 210 operatorë ekonomikë që janë përfshirë vitet e fundit në procedura tenderimi në Bashkitë Berat, Fier, Himarë dhe Sarandë.

Studimi u realizua duke përdorur disa instrumenta si: intervista të drejtëpërdrejta me operatorët ekonomikë (OE) në të katër bashkitë përmes një pyetësori të strukturuar, tre fokus grupe me përfaqësues të OE dhe informacione të marra nga bashkitë.

Instrumenti kryesor i vrojtimit ishte një pyetësor standard. PA morën listat e operatorëve ekonomikë nga bashkitë respektive dhe i ftuan të gjitha kompanitë për t'u bërë pjesë e studimit. Përfshirja në studim e OE ishte një ndër sfidat kryesore të ndeshura gjatë procesit të monitorimit. Të shprehurit hapur, veçanërisht për çështje sensitive e që lidhen drejtpërsëdrejti me aktivitetin ekonomik të OE, funksionimin e sistemit, transparencën dhe trajtimin e barabartë e të drejtë të OE, mbetet një ndër vështirësitë kryesore. Kështu, ndër 210 operatorë ekonomikë të cilët u kontaktuan dhe ftuan për t'u bërë pjesë e këtij studimi, vetëm 60 prej tyre ose 28.6 % u përfshinë në procesin e intervistimit. Pyetjet e pyetësorit adresonin eksperiencën e përgjithshme të të intervistuarve në lidhje me prokurimet elektronike duke u bazuar në eksperiencën me bashkinë dhe në përvojën e tyre të përgjithshme me këto procedura, e krahasuar kjo me periudhën përpara vendosjes së tyre. Metoda e intervistimit ishte ballë për ballë.

Tabela 1: Shpërndarje e kampionit

QARKU	SHPËRNDARJA E KAMPIONIT	SHPËRNDARJA NË%
Vlorë	25	41.7
Fier	10	16.7
Berat	14	23.3
Tiranë	9	15.0
Të tjera	2	3.4
Gjithësej	60	100.0

Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë kryesisht në formën e frekuencave. Numri i vogël i pyetësorëve nuk lejonte kryqëzim të vlerave. Në çdo Grafiku tregohet numri i përgjithshëm i përgjigjeve. Përqindjet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Marzhi i gabimit për një kampion të madhësisë 60 OE është afërsisht 8%, me interval besimi 90%. Për disa pyetje, madhësia e kampionit ishte më e vogël (e cilësuar aty ku duhet), kështu që marzhi i gabimit është më i lartë. Për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve disa kategori përgjigjesh janë grupuar së bashku.

Në vijim të realizimit të intervistave, u organizuan tre fokus grupe respektivisht në Bashkitë Berat, Fier e Sarandë me pjesëmarrjen e 26 operatorëve ekonomikë të cilët kishin qenë të paktën një herë pjesë e procedurave të prokurimit publik kryer nga këto bashki. Diskutimet në fokus grupe bënë të mundur një shkëmbim të gjerë mendimesh me operatorët ekonomikë në lidhje me prokurimin elektronik. Kjo shërbeu për t'i venë në kontekst të dhënat e nxjerra përmes pyetësorit dhe për të shpjeguar tendencat e vëzhguara, si dhe ndihmoi në nxjerrjen e përfundimeve të argumentuara mirë.



DISA KONSIDERATA mbi prokurimin publik elektronik dhe kuadrin ligjor

PROKURIMI PUBLIK ELEKTRONIK DHE PËRPARËSITË E TIJ

Sipas Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD, 2013) prokurimi publik është procesi i blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve nga qeveritë dhe ndërmarrjet pronë shtetërore.

Termi “prokurim elektronik” është diskutuar gjerësisht si në sektorin publik dhe atë privat (Panayiotou et al., 2004) si një perspektivë për të rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve nga ana e qeverive.

Prokurimi elektronik, sipas Davila et al., (2003), mund të përkufizohet si çdo teknologji e konceptuar për të lehtësuar procesin e blerjes së mallrave nga subjekte private ose qeveritare përmes internetit. Banka Botërore e përkufizon prokurimin publik elektronik si përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (veçanërisht internetit) nga qeveritë për të realizuar procesin e prokurimit me furnizuesit e mallrave, punëve dhe shërbimeve të konsulencës të kërkuara nga sektori publik (Banka Botërore, 2003).

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) e sheh prokurimin publik si një mekanizëm strategjik që menaxhon në mënyrë efikase shpenzimet e qeverisë në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve të ndryshme; inkurajon sinergji, sjell risi dhe rritje ekonomike dhe të tregut dhe gjithashtu garanton mbrojtjen e mjedisit, e mundësive për të sjellë kursime financiare (OECD 2013).

Shtetet pjesëmarrëse të OECD kanë si shqetësim parësor kursimin për të konsoliduar financat publike e krijimin e hapësirave fiskale për politika të tjera. Për këtë arsye një sërë shtetesh kanë filluar të përdorin mjete novatore për të arritur ekonomitë e shkallës, duke ristrukturuar funksionet e tyre blerëse, duke konsoliduar blerjet dhe duke futur në përdorim teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në procesin e prokurimit.

Interesi i administratës publike për prokurimin elektronik mund t'i atribuohet veçanërisht shkallës së lartë të shpenzimeve publike të cilat përfaqësojnë 13% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në shtetet e OECD dhe 19% të PBB në vendet anëtare të Bashkimit Evropian (Komisioni Evropian 2013; OECD, 2013). Sipas OECD, në 2012 vëllimi i tregut të prokurimit publik në vendet në zhvillim ishte 25-30% të PBB me disa nivele edhe më të larta në disa ekonomi në zhvillim: 35% në Afrikën e Jugut, 43% në Indi dhe 47% në Brazil.

Duke qenë se prokurimi publik përfaqëson një pjesë të rëndësishme të PBB, zbatimi i prokurimit elektronik do të gjeneronte kursime dhe do të jepte kontributin e tij në përpjekjet për të konsoliduar financat publike.

Efektiviteti mund të arrihet me anë të mjeteve të ndryshme si adaptimi i teknologjive të informacionit e komunikimit dhe konsolidimi i blerjeve për të arritur ekonomitë e shkallës. Duke marrë në konsideratë peshën e madhe të shpenzimeve me anë të prokurimit publik, ulja e tyre si rezultat i rritjes së efektivitetit me anë të prokurimit elektronik do të krijonte hapësira për politika fiskale ekonomike dhe sociale.

Politikat e prokurimit publik elektronik përdoren nga shtetet e OECD jo vetëm për të rritur vlerën ekonomike që mund të krijohet nga investimi i parave, por gjithashtu për të ndjekur objektivat e politikave. Këto objektiva janë të projektuara për të nxitur inovacionin, promovuar zhvillimin e qendrueshëm, përkrahjen e zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe për të krijuar shance të barabarta për pjesëmarrje në mundësitë ekonomike (OECD, 2013).

Në nivel kombëtar, përdorimi i përjashtimeve në tenderimet me konkurrim pengon konkurrencën e lirë. Në mënyrë që vendet të maksimizojnë konkurrencën e në të njëjtën kohë të sigurojnë efektivitetin e procesit të prokurimit, është thelbësore që përjashtimet të përdoren rigorozisht vetëm në një numër të kufizuar rrethanash. Përjashtimet në tenderat me konkurrim mund të bëhen pre e abuzimit, i cili dëmton efektivitetin në pjesën administrative të prokurimit.

PROKURIMI ELEKTRONIK PUBLIK NË SHQIPËRI

Reforma në fushën e prokurimeve publike u zbatua në Shqipëri për herë të parë në vitin 2008, me mbështetjen e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit. SPE menaxhohet nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe mund të përdoret nëpërmjet faqes së internetit të APP-së. Me vendim të Këshillit të Ministrave duke filluar që nga Janari 2009 të gjitha institucionet publike duhet t'i realizonin prokurimet vetëm përmes SPE-së, duke eliminuar në këtë mënyrë përdorimin e procedurave të prokurimit në letër. Ndërsa aplikimi elektronik i blerjeve të vogla nga institucionet publike është një standard i ri që u vendos për herë të parë në vitin 2013. Qëllimi i këtyre procedurave ishte të siguronin barazi më të madhe në procedurat e prokurimit publik, rritjen e transparencës dhe konkurrencës midis operatorëve ekonomikë, si dhe uljen maksimalisht të mundësive për abuzim në procedurat e prokurimit.

Kuadri institucional rregullator në fushën e prokurimit publik përbëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).

APP është organi qendror për mbikqyrjen dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat (PPP) dhe ankandëve publike. APP ka disa kompetenca, të cilat përfshijnë paraqitjen e propozimeve për ndryshime ligjore në fushat e lartpërmendura dhe dhënien e këshillave dhe asistencës ligjore (sipas kërkesës) për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin procedura prokurimi publik, koncesionesh/PPP dhe ankande publike.

KPP është organi i rishikimit, i cili trajton ankesat e operatorëve ekonomikë për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik. Vendimet e KPP janë përfundimtare administrativisht.

Sistemi i prokurimit elektronik është ndërtuar në bazë të direktivave, standardeve dhe kërkesave funksionale të BE-së. Avantazhet kryesore të SPE janë:

- Prokurimi publik përmes përdorimit të teknologjive të informacionit është më i lehtë, sepse i bën procedurat më të shpejta dhe i thjeshtëzon ato.
- Ky sistem rezulton më pak i kushtueshëm, sepse eliminon dokumentet e tepërta shkresore dhe rrit konkurrencën dhe për rrjedhojë ul kostot e kontraktimit.
- SPE është më transparent, sepse mundëson rritjen e fluksit të informacionit dhe redukton ndërhyrjen nga persona të ndryshëm.
- Prokurimi publik elektronik rrit shkallën e përgjegjshmërisë, duke çuar kështu në një përdorim më eficient dhe të efektshëm të parave të taksapaguesve.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR PËR PROKURIMIN PUBLIK ELEKTRONIK

Ligji bazë që rregullon veprimtarinë e prokurimit publik është Ligji nr. 9643 dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik,” i ndryshuar. Ai rregullon të gjithë llojet e prokurimit, përfshirë blerjen e mallrave, punëve, shërbimeve dhe shërbimet e konsulencës. Që prej hyrjes në fuqi të tij, në Nëntor 2006, disa ndryshime ligjore kanë pasuar, veçanërisht vitet e fundit. Gjithashtu, përmes një serie aktesh nënligjore si Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzime, janë ndryshuar disa rregulla e procedura të prokurimit publik. Disa prej këtyre ndryshimeve të viteve të fundit dhe konsiderata mbi to, paraqiten në këtë raport studimi.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit me mjete elektronike” solli ndryshime në drejtim të procedurave për kryerjen e prokurimeve me vlerë të vogël, rritjes së transparencës e reduktimit të abuzimit, si dhe nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Në vitin 2012 u bënë ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar¹ me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Më poshtë do të jepen disa konsiderata mbi këto ndryshime kryesore dhe shtesa të tjera të 2013-ës.

1 Ky ligj është përafëruar pjesërisht me: Direktivën 2004/18/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, datë 31 mars 2004 “Mbi koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime”, Numri CELEX: 32004L0018 , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 134, datë 30.4.2004, faqe 114 – 240; Direktivën 2007/66/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, datë 11 dhjetor 2007, e cila ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/KE dhe 92/13/KEE për përmirësimin e efektshmërisë së procedurave të rishikimit, në lidhje me shpalljen fituese të kontratave publike”, Numri CELEX: 32007L0066 , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 335, datë 20.12.2007, faqe 31 – 46.

Përkufizimi i ri që ligji jep mbi procedurën “kërkesë për propozim” nënvizon se numri i kufizuar i operatorëve ekonomikë të përzgjedhur nuk përjashton edhe paraqitjen e ofertave nga operatorë të tjerë ekonomikë të cilët mund të jenë të interesuar. Ky ripërkufizim lehtëson konkurrencën e lirë dhe kontribuon në oferta më të favorshme për kontratën e ofertuar.

Neni 13 i ligjit përshkruan detyrat e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe arsyet e përjashtimit të mundshëm të një operatori ekonomik nga procedurat e prokurimit. Shtesa në këtë nen shpreh se një operator ekonomik do të përjashtohet nga procedurat e prokurimit nëse nuk i ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe gjithashtu nëse ka një vendim nga Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta. Shtesa në këtë nen ka rëndësi pasi vendos limite të qarta se kur APP ka të drejtë të përjashtojë operatorët ekonomikë kur nga ana e tyre ka sjellje jo në përputhje me ligjin.

Një nga shtyllat themelore që garanton një funksionim të mirë të sistemit të prokurimit publik dhe konkurrencën e lirë është aksesit i barabartë i operatorët ekonomikë në informacion. Për këtë arsye shtesat në nenin 21 janë të rëndësishme. Sipas këtyre shtesave, autoriteti kontraktor është i detyruar të verë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës dhe shton se ky informacion i shkon edhe çdo ofertuesi të suksesshëm (pika c) edhe mbi klasifikimin e ofertave të përzgjedhura.

Pjesë e rëndësishme e aksesit të barabartë në informacion është edhe përdorimi i formave të komunikimit të njëjta e jodiskriminuese për të gjithë. Në këtë mënyrë, ndryshimet në nenin 22 theksojnë se rregullat dhe procedurat për formën elektronike të komunikimit përcaktohen në rregullat e prokurimit publik, sipas parimeve të prokurimit publik të mosdiskriminimit.

Në nenin 36 shpjegohen më në detaje rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike dhe ofertave elektronike. Rregullat për komunikimet elektronike janë në përputhje me legjisllacionin përkatës. Në rast se dokumentet e kërkuara sipas ligjit nuk janë të paraqitura në formë elektronike, mund të paraqiten përpara APP-së.

Një tjetër shtesë me rëndësi është ajo në nenin 38 ku theksohet se kontratat publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesës për propozim ose shërbim konsulence do të shpallen me anë të një njoftimi publik, sipas ligjit përkatës.

Në rastet kur përdoret procedura e kufizuar dhe procedura me negociim, kandidatët janë të ftuar të paraqesin ofertën e tyre për kualifikim në fazën e parë. Minimumi për të vazhduar procedurën e prokurimit publik është 2 kandidatë. Këtu përjashtohet rasti i procedurës me negociim, pa shpallje paraprake.

Dokumentet e tenderit vihen në dispozicion falas në rrugë elektronike nga autoriteti kontraktor. Një pjesë e rëndësishme e shtesave në këtë nen është theksimi se numri i operatorëve ekonomikë të cilët kanë shprehur interes për blerjen e dokumentacionit, pra jo në formë elektronike, duhet të mbahet sekret.

Sipas ndryshimeve në nenin 55, mbi Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, oferta do të konsiderohet fituese nëse qëndron një nga dy pikat e mëposhtme:

- Oferta është ajo me çmimin më të ulët, ose
- Oferta është ekonomikisht më e favorshme.

Nëse të gjitha kriteret e tjera të përmendura në nenin 55 do të përmbushen, ky ndryshim në ligj lejon që të merret në konsideratë në vlerësimin e një oferte jo vetëm çmimi por edhe cilësia. Ky ndryshim është i rëndësishëm sepse bën të mundur që karakteristika të tjera të objektit të kontratës si ato funksionale, të efektshmërisë ekonomike, të asistencës teknike pas blerjes së objektit të kontratës etj. të bëhen pjesë e vlerësimit total.

Për sa i përket njoftimit të fituesit dhe nënshkrimit të kontratës, sipas nenit 58, autoriteti kontraktor ka pesë ditë kohë për të kaluar informacionin mbi fituesin në Buletinin e Njoftimeve. Pika 1 gjithashtu përmban informacione mbi çfarë duhet të përmbajë minimalisht njoftimi mbi ofertuesin fitues.

Një pikë tjetër e rëndësishme e ndryshimeve në këtë nen, është pika 5 në të cilën shprehet se ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave përzgjidhet nëse ofertuesi fitues nuk nënshkruan kontratën ose bën sigurimin e kontratës, nëse është e kërkuar diçka e tillë.

Në nenin 63 "Të drejtat e personit të interesuar" është shtuar pika 1.1. në të cilën shprehet koha prej 7 ditësh në dispozicion të operatorëve ekonomikë për t'u ankuar pranë autoritetit kontraktor. Kjo shtesë është e nevojshme pasi një procedurë e mirëorganizuar e ankesave është një nga shtyllat kryesore për të siguruar se sistemi i prokurimit publik funksionon në mënyrën dhe kohën e duhur. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e kësaj shtese është edhe fakti që autoriteti kontraktues nuk mund të vazhdojë procedurën e prokurimit deri në momentin që ankesa është shqyrtuar plotësisht.

Në rastin e një vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik palët kanë të drejtë që në gjykatën përkatëse të bëjnë padi kundër vendimit të mosmarrëveshjes administrative, sipas ndryshimeve në nenin 64/3.

Neni 65 përshkruan të drejtat e Agjencisë së Prokurimit Publik në procedurat e hetimit administrativ, siç janë e drejta për të kryer hetime administrative në vend, për të kërkuar informacion e shpjegime nga organet e administratës qendrore

e vendore, për të marrë në pyetje dhe për të kërkuar ekspertizë. Gjithashtu, sipas pikës 3, APP ka të drejtë që për të kryer funksionet e saj të ketë akses në të gjitha zyrat e institucioneve të autoriteteve kontraktore. Për mirëfunksionimin e procedurës së hetimit administrativ e për të ndihmuar në funksionet e saj, APP ka të drejtë të vendosë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të saj për informacion.

Sipas nenit 66, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë dy lloje vendimesh pas një hetimi administrativ: të mbyllë hetimin në rast se nuk është gjendur një shkelje ligji, ose të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë për shkeljet e gjetura. Njoftimi i të gjitha vendimeve jepet me shkrim.

Me rëndësi në reformën rregullatore të Prokurimit Publik është dhe përcaktimi i kufijve monetarë. Sipas legjislacionit në fuqi, kufijtë monetare ndahen sipas llojit të kontratave (kontrata për punë publike dhe kontrata për shërbime dhe mallra) dhe sipas vlerës monetare (kufiri i lartë monetarë dhe kufiri i ulët monetar).

Tabela 2: Kufijtë monetarë sipas llojit të kontratave

KUFIRI MONETAR	LLOJI I KONTRATËS	
	KONTRATA PËR PUNË PUBLIKE	KONTRATAT PËR SHËRBIME DHE MALLRA
KUFIRI I LARTË MONETAR	1,200,000,000	200,000,000
KUFIRI I ULËT MONETAR	12,000,000	8,000,000

Kontratat vlera e të cilave është më e ulët se 400,000 lekë përfshihen tek prokurimet me vlerë të vogël.

“Udhëzimi mbi prokurimet me vlera të vogla” daton prej 28.03.2013 “Për Procedurën E Prokurimit Me Vlera Të Vogla”, i ndryshuar më pas me Udhëzimin Nr.5, datë 16.07.2013, Udhëzimin Nr. 1, datë 28.02.2014 dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015.

Në mënyrë të përmbledhur ky udhëzim vendos se vlera e mallrave, shërbimeve dhe punëve gjatë vitit buxhetor nuk duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë në mënyrë që të përdoret procedura e prokurimeve me vlerë të vogël (pa përfshirë TVSH-në).

Gjithashtu, sipas këtij udhëzimi autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura blerje me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, por shuma e këtyre procedurave për të njëjtin mall, shërbim ose grup mallrash nuk duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë në vit. Me udhëzimin e vitit 2015 ky limit rritet dhe nuk duhet të jetë më i madh se 800.000 (tetëqindmijë) lekë.

Kjo lloj procedure duhet të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Në udhëzim theksohet që: *“përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave normale të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.*

Qeveria ka vendosur gjithashtu të shmangë rastet kur kompanitë bëjnë oferta shumë të ulta në kurriz të cilësisë. Sipas vendimit, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo zbret më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur. Gjithashtu, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së tri ofertave të vlefshme. Por nuk është parashikuar ofertë anomalisht e ultët për blerjet me vlerë të vogël.

Në fushën e prokurimit publik ka pasur progres të mirë në procesin e përafrimit me legjislacionin respektiv të BE. Sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Shqipëria ka përmbushur angazhimet e saj në këtë fushë e përafrimit të legjislacionit për Prokurimin Publik Elektronik në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Kuadri ligjor dhe institucional siguron një bazë të mirë për zhvillimin e një sistemi efektiv të prokurimit publik sipas rregullave të BE-së.




5

GJETJET KRYESOREmbi eksperiencën
e operatorëve ekonomikë
me prokurimin publik**5.1 KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË KAMPIONIT**


Një nga instrumentat kryesorë që u përdorën për këtë studim ishte realizimi i intervistave të drejtpërdrejta me OE. Karakteristikat kryesore të kampionit të përdorur janë dhënë në mënyrë të përmblodhur në Grafikon 1 si më poshtë.

Grafiku 1: Shpërndarja e kampionit sipas formës ligjore të biznesit (n=60)




Pjesa më e madhe e operatorëve ekonomikë të intervistuar (82%) janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Megjithatë realizimi i prokurimeve on-line për “Blerjet e vogla” ka ndikuar në rritjen e numrit të personave fizik që marrin pjesë në procedurat e prokurimit. Këto subjekte janë përfaqësuar në kampion në masën 18% (Grafiku nr. 1).

Grafiku 2: Shpërndarja e kampionit sipas veprimtarisë kryesore të biznesit (n=60)



Kampioni ka një shpërndarje pothuajse të barabartë midis tre sektorëve kryesorë të ekonomisë (ndërtimit, shërbimeve dhe tregtisë). 38% e operatorëve ekonomikë kanë si aktivitet kryesor ndërtimin, 33% kanë si aktivitet kryesor shërbimet dhe 29% tregtinë. Kjo shpërndarje diktohet kryesisht nga natyra e prokurimeve që kanë realizuar njësitë e qeverisjes vendore. Në pjesën më të madhe ato kanë prokuruar mallra dhe shërbime e numri i procedurave që lidhen me punë në dy nga katër bashkitë e monitoruara (Fier dhe Himarë) ka qenë i kufizuar për vitin 2014 (Grafiku nr. 2).


Grafiku 3: Shpërndarja e kampionit sipas numrit të të punësuarve (n=60)



37% e operatorëve ekonomikë të intervistuar punësojnë 1-9 punonjës, 53% punësojnë 10-49 punonjës, dhe vetëm 10% kanë më shumë se 50 punonjës. Karakteristikat e kampionit ndryshojnë sipas rajoneve dhe sektorëve kryesorë të ekonomisë. Megjithatë ajo që konstatohet është që 90% e operatorëve të intervistuar janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (Grafiku nr. 3).

OE me numrin më të vogël të të punësuarve e zhvillojnë aktivitetin e tyre kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve. Nga 22 OE të intervistuar që kanë të punësuar 1-9 punonjës, 54.4% zhvillojnë aktivitet tregtar dhe 36.3% ofrojnë shërbime.


Grafiku 4: Shpërndarja e kampionit sipas numrit mesatar të procedurave në një vit (n=60)




Operatorët ekonomikë të intervistuar kanë dallime përsa i përket frekuencës së pjesëmarrjes së tyre në procedurat e prokurimit publik. Kështu 38% e OE të intervistuar kanë marrë pjesë mesatarisht në 51-100 procedura prokurimi gjatë një viti. Ndërsa 20% e OE kanë marrë pjesë deri në 10 procedura prokurimi dhe po aq kanë marrë pjesë në 11-50 procedura prokurimi.

OE që marrin pjesë mesatarisht në mbi 51 procedura e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e ndërtimit (28.3%) dhe shërbimeve (20%) (Grafiku nr. 4).


Grafiku 5: Shpërndarja e kampionit sipas eksperiencës së përgjithshme me prokurimet publike (n=60)



Kampioni përfshin OE me eksperiencë të ndryshme në fushën e prokurimeve publike. Pjesa më e madhe e OE të intervistuar (61%) kanë eksperiencë mbi 5 vjet në prokurimet publike. Ndërkohë që afërsisht 1/3 e tyre kanë eksperiencë mbi 10 vjet. Eksperiencë relativisht e gjatë në fushën e prokurimeve i mundëson OE të japin opinionin e tyre mbi ndikimin që ka patur ndryshimi i legjislatcionit dhe futja e prokurimeve elektronike si mënyra kryesore për prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve nga institucionet publike (Grafiku nr. 5).

Grafiku 6: Xhiroja vjetore e kompanisë në vitin 2013 (n=60)

Kampioni përfshin një larmi operatorësh ekonomikë për sa i përket xhiros vjetore. 43% e OE të intervistuar kanë një xhiro vjetore 10-50 milion lekë, ndërsa më shumë se 1/3 e OE ose 37% kanë një xhiro vjetore 51-150 milion lekë. Numri i OE me xhiro vjetore mbi 251 milion-1 miliard lekë është i vogël (vetëm 12% e OE të intervistuar). Rreth 1/3 e OE të intervistuar që marrin pjesë në mbi 51 procedura prokurimi në vit e kanë qarkullimin vjetor mbi 51 milion lekë (Grafiku nr. 6).

Grafiku 7: Pjesa e xhiros vjetore që realizohet nga kontratat me Autoritetet Kontraktore (n=58)

Afërsisht 1/5 ose 22% e OE të intervistuar realizojnë mbi 51-75% të xhiros së tyre vjetore nga kontratat që marrin nga autoritet kontraktore. 25% e OE të intervistuar realizojnë nën 10% të xhiros vjetore nga kontratat me AK. Vetëm 16% e OE realizojnë mbi 96% të xhiros së tyre nga kontratat me AK (Grafiku nr. 7).

Për periudhën Janar-Dhjetor 2014 u monitoruan gjithashtu 143 procedura prokurimi. Llojet e procedurave të monitoruara dhe tipet e kontratave sipas bashkive jepen në tabelën 3 dhe 4.

Tabela 3: Shpërndarja e rasteve të monitoruara sipas llojit të procedurës (Janar-Dhjetor 2014)

BASHKIA	LLOJI I PROCEDURËS				
	BLERJE E VOGËL	KËRKESË PËR PROPOZIM	PROCEDURA TË HAPURA	PROCEDURA ME NEGOCIM	SHËRBIM KONSULLENCE
Berat	22	13	5	-	-
Fier	15	4	5	2	1
Himarë	10	3	7	-	-
Sarandë	37	42	2	-	-

Tabela 4: Shpërndarja e rasteve të monitoruara sipas tipit të kontratës (Janar-Dhjetor 2014)

BASHKIA	TIPI I KONTRATËS		
	PUNË	MALLRA	SHËRBIME
Berat	8	25	7
Fier	4	12	11
Himarë	10	6	4
Sarandë	40	34	7


Në fokus grupet e realizuara në tre bashki operatorët ekonomikë diskutuan në lidhje me eksperiencat individuale në procedurat e prokurimeve publike. Ata shprehën opinionet e tyre mbi rëndësinë e ndryshimeve në kuadrin ligjor, funksionimin e portalit të APP, aksesin që kanë në informacionet e publikuara mbi procedurat e prokurimit, aplikimin e të drejtës për t'u ankimuar, zbatimin e procedurave nga ana e AK, etj.

Opinionet, perceptimet dhe problematikat kryesore që kanë dalë nga pyetësi dhe që u ngritën në fokus grupe, takime e intervista me drejtues të bashkive, specialistë të njërive të prokurimeve dhe operatorë ekonomikë, paraqiten në vijim në mënyrë të përmbledhur sipas problematikave.


5.2 EKSPERIENCA E OPERATORËVE EKONOMIKË ME BASHKITË

Pjesa më e madhe e OE (69%) i ofrojnë shërbimet e tyre dhe në njësi të tjera të qeverisjes vendore. 1/5 e OE kanë eksperiencën me 2-3 bashki të tjera, ndërkohë që më shumë se 1/3 kanë eksperiencën me më shumë sesa 5 bashki (Grafiku nr. 8).

Grafiku 8: Eksperiencën e Operatorëve Ekonomikë me bashki të tjera (n=60)



Grafiku 9: Kënaqësia e Operatorëve Ekonomikë me procedurat e prokurimit publik (n=53)



Siç paraqitet në Grafikun nr. 9, më shumë se gjysma e OE të intervistuar (54%) janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur nga procedurat e prokurimit të realizuara nga AK respektive. Por ka dhe OE që janë të pakënaqur dhe plotësisht të pakënaqur me procedurat e prokurimit publik (25%).

OE që nuk kanë marrë pjesë në tenderat e bashkive ku zhvillojnë aktivitetin e tyre kanë dhënë dhe arsytet për këtë veprim. Një nga arsytet e përmendura më shpesh ka qënë mosofrimi i mallrave dhe shërbimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Shkaqe të tjera janë mungesa e besimit që kontratat jepen mbi bazën e konkurrencës, rregullat dhe procedurat e prokurimit publik janë shumë të vështira për të punuar me to, etj (Tabela 5).

Tabela 5: Arsyet për mospjesëmarrje në procedurat e prokurimeve publike


ARSYET PËR MOSPJEËMARRJE NË PROCEDURAT E PROKURIMEVE PUBLIKE (N=17)	NUMRI RASTEVE	NË%
Biznesi im nuk ofron mallra ose shërbime që kërkohen zakonisht nga autoritetet vendore	7	41.2%
Rregullat dhe procedurat e prokurimit publik janë shumë të vështirë për të punuar me to	3	17.6%
Biznesi im nuk ka burime të mjaftueshme për të investuar në prokurimet publike	1	5.8%
Publiciteti i pamjaftueshëm i thirrjeve për prokurime	1	5.8%
Nuk besoj se kontratat publike jepen mbi baza konkurruese	3	17.6%
Kam qenë i pasuksesshëm në të kaluarën dhe tani nuk jam më i interesuar	1	5.8%
Arsye tjetër. Ju lutem specifikoni	1	5.8%

5.3 PROCEDURAT E ANKIMIT

Vetëm 41.7% e të intervistuarve (n=25) kanë kërkuar ndonjëherë shqyrtimin dhe/ose kanë bërë ankesë, kur kanë qenë të pakënaqur me rezultatin/procedurat e prokurimit të ndjekura nga AK.

Përgjithësisht operatorët që kanë bërë ankimim në lidhje me procedurat e prokurimit kanë ndjekur të gjitha hapësitat që parashikon ligji për të shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me rezultatin e shpallur nga AK apo procedurat e ndjekura prej tyre.

Grafiku 10: Hapat e ndjekura për t'u ankimuar (n=54)



Siç paraqitet në Grafikon nr. 10, 39% të OE i kanë drejtuar kërkesë Autoritetit Kontraktor si organi administrativ i autorizuar për të rishikuar dhe/ose pezulluar vendimet. Por ata kanë shfrytëzuar dhe hapa të tjera të ankimimit si kërkesë/ ankesë pranë APP (30%) apo Komisionit të Prokurimit Publik (31%).

Megjithatë ka OE të cilët janë shprehur se kanë frikë të ndjekin procedurat e ankimimit, sepse mendojnë se mund të penalizohen në të ardhmen pavarësisht se mendojnë që është marrë një vendim i padrejtë.

OE gjithashtu nuk kanë shumë informacion pse duhet të paguhet për procedurat e ankimimit dhe nuk e dinë nëse shumat kthehen mbrapsht nëse fitohet.

Një pjesë e OE kanë eksperiencë pozitive me procedurat e ankimimit, pra i'u është pranuar kërkesa dhe procedura është anuluar, por ka dhe nga ata që nuk kanë fare besim që mund të zgjidhin diçka. Por ndërkohë ka dhe OE që nuk janë ankimuar. Arsyet që ata japin pse nuk kanë ndjekur këtë procedurë janë të ndryshme. Ndër to mund të veçohen mungesa e besimit për shqyrtimin e ankesave/vendimeve (20.9%) dhe ngadalësia në shqyrtimin e ankesave (18.6%), të cilat janë ndër arsyet kryesore që i frenojnë OE të ndjekin hapat e përcaktuara nga ligji për ankimimin (Tabela 6).




Tabela 6: Arsyet e mosankimit pranë Autoriteteve Kontraktore

ARSYET PËRSE NUK JANË ANKUAR (N=43)	NUMRI	NË%
Frika që nëse ankohesh nuk mund të fitosh kontrata të ardhshme nga ai autoritet kontraktor	3	6.9%
Nuk kam besim në sistemin për shqyrtimin e ankesave / vendimeve	9	20.9%
Nuk kishte mundësi për të apeluar pasi kontrata ishte nënshkruar kur unë u njoha me vendimin	6	13.9%
Sistemi i shqyrtimit është shumë i ngadaltë	8	18.6%
Kostot e mundshme ligjore	1	2.3%
Niveli i mundshëm i shpërblimit është i pamjaftueshëm për të mbuluar humbjet	1	2.3%
Kostot financiare janë të larta	3	6.9%
Arsye të tjera	12	27.9%

5.4 INFORMACIONI MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT

OE e marrin informacionin për thirrjet e reja për prokurime publike në faqen e APP. Vetëm në raste të rralla OE marrin ftesë nga AK nëse duan të ofertojnë për procedura të caktuara. Në përgjithësi OE i referohen faqes së APP pavarësisht se mund të ketë probleme për të gjetur me lehtësi informacionin e përditësuar.


Grafiku 11: Informacioni në lidhje me tenderat (n=60)



Më shumë se gjysma e të anketuarve përdorin si burim për të marrë informacion në lidhje me prokurimet publike internetin, ndërsa 42% e të intervistuarve

përdorin buletin e prokurimeve publike si burim për t'u informuar në lidhje me tenderat. Vetëm 6% e të intervistuarve përdorin burime të tjera si gazetat, ftesa të drejtëpërdrejta apo kontaktet personale për të marrë informacion në lidhje me tenderat (Grafiku nr. 11).

Grafiku 12: Plotësia e informacionit që përmbahet në dokumentet e tenderit (n=60)



Pjesa më e madhe e të intervistuarve (77%) mendojnë që informacioni që përmbahet në dokumentet e tenderit është i plotë dhe shumë i plotë, ndërsa 23% mendojnë që informacioni është disi i plotë (Grafiku nr. 12).



6 GJETJET KRYESORE të monitorimit në nivel bashkive

Portali i APP-së për prokurimet publike elektronike u monitorua për një periudhë 12 mujore (Janar-Dhjetor 2014). Disa nga gjetjet specifike për të gjithë periudhën e monitoruar për secilën prej njësive të pushtetit vendor janë:

BASHKIA FIER

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2014 u monitoruan 27 procedura prokurimi në bashkinë Fier. Nga këto vetëm 5 procedura ose 18.5% kanë qenë procedurë "E hapur", 62.9% kanë qenë blerje të vogla dhe pjesa tjetër kanë qenë "Kërkesë për propozime", "Shërbim konsulence" dhe "Procedura me negociim pa shpallje paraprake".
- Nga 27 proceduara të monitoruara 4 kontrata janë lidhur për punë, 12 janë lidhur për mallra dhe 11 për shërbime.
- Bashkia ka venë në dispozicion të organizatës tonë realizimin e planit të prokurimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2014.
- Sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve rezulton se bashkia ka lidhur 27 kontrata përmes procedurave të prokurimit elektronik dhe nga procedurat

e prokurimit është kursyer 4.69% e fondit limit të planifikuar (ose 13,624,120 lekë).

- Kursimi i fondit limit ndryshon në varësi të tipit të kontratës. Kursimet më të mëdha janë në kontratat për shërbime. Ato variojnë nga 1% deri në 90.2%. Në procedurat e hapura kursimi nga fondi limit varion nga 1.9% deri në 19.5%.
- Në listën e firmave fituese konstatohet që dy firma janë kontraktuar nga bashkia 3 herë për shërbime apo mallra të ngjashme.
- Në bashkinë Fier janë hapur katër procedura për blerje kancelarie, letër dhe toner, duke e copëzuar fondin për të respektuar kërkesat për blerje të vogla.
- Numri i operatorëve që kanë marrë pjesë në tendera për mungesë të dhënash nuk mund të llogaritej.

BASHKIA BERAT

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2014 u monitoruan 18 procedura prokurimi në bashkinë Berat, të cilat ndodhen në regjistrin e prokurimeve të realizuara. Nga këto vetëm 5 procedura ose 27.7% kanë qenë procedurë "E hapur" dhe pjesa tjetër kanë qenë "Kërkesë për propozime".
- Nga 18 procedura të monitoruara 6 kontrata janë lidhur për punë, 8 janë lidhur për mallra dhe 4 për shërbime.
- Bashkia ka venë në dispozicion të organizatës tonë realizimin e planit të prokurimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2014.
- Sipas regjistrin të realizimit të prokurimeve rezulton se bashkia ka lidhur 18 kontrata përmes procedurave të prokurimit elektronik dhe është kursyer 9.82% e fondit limit të planifikuar (ose 34,160,391 lekë).
- Kursimi i fondit limit ndryshon në varësi të tipit të kontratës. Kursimet më të mëdha janë në dy kontrata për shërbime (mbi 80%). Ndërsa për 5 kontrata të tjera ato variojnë nga 22-33%.
- PA ka monitorura dhe 22 procedura për blerje të vogla. Fondi limit i kursyer për këto procedura është 10.3%.
- Në listën e firmave fituese konstatohet që ka firma të cilat janë kontraktuar nga bashkia 2 herë për shërbime apo mallra të ngjashme.
- Në bashkinë Berat janë hapur pesë procedura për blerje kancelarie, letre dhe tonera, duke e copëzuar fondin për të respektuar kërkesat për blerje të vogla.

BASHKIA HIMARË

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2014 u monitoruan 20 procedura prokurimi në bashkinë Himarë. Nga këto vetëm 7 procedura ose 35% kanë qenë

procedurë “E hapur”, 50% kanë qenë blerje me vlerë të vogël dhe pjesa tjetër kanë qenë “Kërkesë për propozime”.

- Nga 20 procedura të monitoruara 10 kontrata janë lidhur për punë, 6 janë lidhur për mallra dhe 4 për shërbime.
- Bashkia ka venë në dispozicion të organizatës tonë realizimin e planit të prokurimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2014.
- Në 6 procedura për punë të monitoruara është kursyer nga fondi limit mesatarisht 2.48% dhe numri i OE që kanë marrë pjesë është mesatarisht 2.1.
- Në tre procedura për punë të monitoruara kanë konkuruar 3 kompani në secilën prej tyre, nga të cilat 2 kompani janë skualifikuar. Ky indikator tregon që Konkurrenca në bashkitë që ndodhen larg qendrave të mëdha është shumë e ulët.
- Numri i ulët i firmave pjesëmarrëse ndikon dhe në termat financiarë të prokurimeve publike. Në pjesën më të madhe kursimi nga fondi limit për të gjitha procedurat e hapura apo kërkesë për propozim është luhatur nga 0.1% deri në 3%. Por ka dhe raste si procedura e realizuar për “*Rikonstruksionin dhe sistemimin e fasadave të fshatit Kudhës*”, ku kursimi nga fondi limit ka qenë vetëm 1 lekë.
- Kursimi i fondit limit ndryshon në varësi të tipit të kontratës. Kursimet më të mëdha janë në kontratat për blerje të vogla mallrash apo shërbimesh. PA ka monitoruar 10 procedura për “Blerje me vlerë të vogël”, nga të cilat 3 janë kontrata për punë, 2 për shërbime dhe 5 për mallra. Numri mesatar i OE-ve që kanë marrë pjesë në këto procedura është 9.4. Kursimi nga fondi limit është mesatarisht 29.45%, por ai varion sipas procedurave nga zero në 90%. Devijimi më i madh është për një kontratë shërbimi për mbikqyrjen e punimeve në Kudhës (kursyer 90% e fondit limit).
- PA ka monitoruar 10 kontrata të lidhura “Procedurë e Hapur” dhe “Kërkesë për Propozim” dhe kursimi nga fondi limit rezulton në masën 3.1%.

BASHKIA SARANDË

- Bashkia Sarandë është bashkia që ka publikuar numrim më të madh të procedurave në faqen e APP, por njëkohësisht ajo ka pasur dhe një numër të madh procedurash të anuluar. Kështu Bashkia Sarandë ka shpallur numrin më të madh të procedurave të hapura (56 procedura) në platformën e-prokurime për periudhën Korrik-Shtator 2014, ndërkohë që ka dhe përqindjen më të lartë të procedurave të anuluar (26.7%).
- Për bashkinë Sarandë u monitoruan 45 procedura që janë përfshirë në regjistrin e realizimit të prokurimeve publike për vitin 2014. Nga këto 35 procedura ose 77.7% kanë qenë procedurë për Punë.

- Sipas të dhënave të regjistrit të prokurimeve publike për 45 procedura prokurimi të raportuara është kursyer 10.6% e fondit limit të planifikuar (ose 22,039,254 lekë).
- Për 45 procedura të monitoruara nga regjistri janë shpallur fitues 25 OE, pra i bie mesatarisht më pak se 1 procedurë e fituar nga çdo OE. Të dhënat mbi numrin e firmave që kanë marrë pjesë në tendera nuk ishin të mundura të nxirreshin nga sistemi i APP.
- PA ka monitoruar gjithashtu 37 kontrata për "Blerje të vogla" përmes faqes elektronike të APP. Nga procedurat e prokurimit është kursyer 14.8% e fondit limit të planifikuar (ose 797,188 lekë). Për 10 nga 37 procedurat e monitoruara kursimi është nën 4%. Bashkia ka kontraktuar 9 herë të njëjtin OE për blerje të vogla, pra 27% e kontrateve janë lidhur me një OE.
- Për 45 procedura të monitoruara nga regjistri i realizimeve janë shpallur fituese 25 OE, pra mesatarisht më pak se 1 procedurë e fituar nga çdo OE.
- Nga monitorimi i 45 procedurave rezulton që në bashkinë Sarandë dy firma kanë përfituar një numër të madh kontratash. Një kompani ka fituar 10 nga 45 procedura të monitoruara (ose 22.2%) dhe kompania tjetër 6 procedura (ose 13%). Këta indikatorë janë tregues të mungesës së konkurrencës në procedurat e konkurrimit në këtë bashki.





PERCEPTIME

të përgjithshme mbi procedurat e prokurimit elektronik

Në seksionin në vijim paraqiten disa konsiderata të përgjithshme nga OE mbi procedurat e prokurimit publik elektronik, nivelin e transparencës, konkurrencën në nivel vendor, përdorimin e fondeve si dhe disa problematika lidhur me funksionimin e faqes së internetit të APP dhe problematika të tjera identifikuar nga OE dhe ekipi i studimit.

7.1 NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR

- Ndryshimet ligjore për prokurimet publike kanë qenë pozitive dhe ndihmuese për OE.
- Mundësia e nënkontraktimit ka qenë e dobishme dhe frytdhënëse dhe ka rritur mundësitë për punë të firmave të vogla.
- Procedurat për blerjet me vlerë të vogël janë thjeshtuar shumë. Mbushja e procesverbalit nuk të vonon, por megjithatë disa OE mendojnë që ky proces nuk është shumë transparent. OE mendojnë gjithashtu që blerjet me vlerë të vogël lënë shkas për korrupsion.
- OE e konsiderojnë si pozitiv ndryshimin në ligj për shpalljen e procedurave të prokurimit vetëm në rastet kur AK e kanë fondin në dispozicion. Sipas tyre është shumë mirë që tenderi nuk bëhet pa patur fonde, pasi shumë AK ende kanë fatura të pashlyera ndaj OE nga vitet e kaluara.


- Rritja e limitit për blerjet e vogla është një masë që lehtëson më shumë punën e AK, ndërsa për OE ajo konsiderohet si masë e mirë, por pa ndonjë efekt të madh për ta.
- Vazhdimimi i tenderit edhe kur ka vetëm 1 ofertë konsiderohet si pozitiv, megjithëse kjo perceptohet më shumë si një masë që krijon lehtësira vetëm për AK.
- APP trajton me korrektesë të gjitha ankesat e OE dhe pas procesit të monitorimit të procedurave vendos penalitete të drejta.
- Ligji për prokurimet është tepër tolerant dhe duhet të ndryshojë, duke mbajtur parasysh jo vetëm praktikatat me të mira botërore, por mbi të gjitha specifikat e ekonomisë vendase e sidomos praktikatat korruptive që njihen shumë mirë dhe që duhen evituar me ligj e akte nënligjore.

OE iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse ishin dakord ose jo në lidhje me opinionet e mëposhtme:

- Procedurat dhe rregullat e prokurimit elektronik në përgjithësi janë të lehta për t'u ndjekur.
- Procedurat aktuale të prokurimit sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit.
- Dhënia e tenderave publikë është një proces i drejtë dhe jo-diskriminues.
- Nuk është e vështirë për të marrë informacion/për të gjetur thirrjet për tendera.
- Autoritetet kontraktore vazhdojnë të lidhin kontrata të drejtpërdrejta të cilat janë të vështira për t'u sfiduar nga ofertues të mundshëm.

Perceptimet e OE në lidhje me procedurat dhe rregullat e prokurimit publik janë të ndryshme. Në përgjithësi OE (81%) janë dakord me mendimin që nuk është e vështirë të marrësh informacion mbi tenderat dhe të gjes thirrjet për tendera. Gjithashtu 57% e të intervistuarve janë dakord me mendimin që procedurat dhe rregullat e prokurimit elektronik në përgjithësi janë të lehta për tu ndjekur (Grafiku nr. 13).


Grafiku 13: Informacioni mbi tenderat (N=60)



7.2 TRANSPARENCA E PROCEDURAVE

Pjesa më e madhe e të intervistuarve (75%) mendojnë që procedurat aktuale të prokurimit janë transparente dhe shumë transparente. Por ¼ e të intervistuarve (25%) mendojnë që procedurat janë pak transparente ose jo transparente (Grafiku nr. 14).

Grafiku 14: *Transparenca e procedurave (n=60)*



- Portali on-line i APP mundëson monitorimin e hapjes së procedurave të tenderimit për të gjitha rastet e parashikuara nga ligji. Por monitorimi i shpalljes së fituesve pas mbylljes së procedurës paraqet vështirësi, pasi një pjesë e madhe e procedurave arkivohen menjëherë pas përfundimit të tyre nga AK dhe për publikun nuk ka akses në arkivin e faqes.
- Buletini i Prokurimeve është një burim alternativ për të marrë informacion mbi fituesit e tenderave, fondin e kontraktuar dhe numrin e firmave që kanë marrë pjesë në tender për "Procedurat e Hapura", "Kërkesë për Propozim" dhe "Procedurat me Negocim".
- Megjithatë në platformën on-line është e vështirë të identifikosh OE që shpallen fitues për blerjet e vogla në pjesën më të madhe të rasteve, pasi procedura arkivohet menjëherë nga AK. Nëse arkivimi i procedurës bëhet me disa ditë vonesë është e mundur marrja e informacionit për fondin e kontraktuar dhe OE fitues, por nuk merret informacion mbi numrin dhe emrat e OE që kanë marrë pjesë në këtë procedurë.
- APP së fundmi ka bërë ndryshime në platformë për të rritur transparencën ndaj publikut për procedurat e prokurimeve të realizuara. AK mund t'i


shpallin tek Njoftimi i Fituesit, të gjithë operatorët ekonomikë fitues të procedurave pavarësisht nga lloji i procedurës. Për periudhën janar-prill 2015 AK e kanë paraqitur këtë informacion në portalin e APP.

- Në portalin e APP publikohen gjithashtu dy regjistra në lidhje me prokurimet: Regjistri i Parashikimeve dhe Regjistri i Realizimit të Prokurimeve. Në regjistrin e realizimit të prokurimeve për vitin 2014 mungojnë bashkitë Berat, Sarandë dhe Himarë. Ndërsa informacioni i publikuar për bashkinë Fier nuk përmban tipin e kontratës, numrin dhe emrin e kompanive pjesëmarrëse në secilën procedurë.
- Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2015 janë publikuar vetëm parashikimet për bashkitë Berat dhe Himarë dhe mungojnë për bashkinë Fier dhe Sarandë. Për të dyja bashkitë që kanë publikuar parashikimet mungojnë procedurat e “Blerjeve të Vogla”.
- Në portalin e APP për vitin 2014 nuk janë publikuar të gjitha njoftimet për kontratat e lidhura nga Autoriteti Kontraktor dhe njoftimi i fituesit, megjithëse ky opsion ofrohet nga platforma on-line.
- Arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë jepen në të gjitha njoftimet e publikuara në buletin e prokurimeve elektronike.


7.3 KONKURRENCA NË PROKURIMET PUBLIKE

Një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve janë disi dakord që procedurat aktuale të prokurimit sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit (40%) dhe që dhënia e tenderave publikë është një proces i drejtë dhe jo-diskriminues (42%). 1/3 e të intervistuarve janë disi dakord me mendimin që autoritetet kontraktore vazhdojnë të lidhin kontrata të drejtpërdrejta të cilat janë të vështira për t'u sfiduar nga ofertues të mundshëm (Grafiku nr. 15).

Grafiku 15: Barazia në tendera (n=60)



- Konkurrenca në procedurat “Kërkesë për propozim” dhe “Procedurë e Hapur” mbetet e ulët. Në procedurat për punë numri i OE që marrin pjesë në prokurime është i ulët, jo më shumë se 3 dhe në disa raste 2 prej tyre janë skualifikuar. Ka patur dhe procedura në të cilat ka marrë pjesë vetëm një kompani. Por ka dhe raste si bashkia Fier ku numri i konkurrentëve ka qenë më i madh.
- Në procedurat “Blerje me vlerë të vogël” ka konkurrencë të madhe. Numri i OE është i konsiderueshëm, por megjithatë AK përballen dhe me raste ku ofrohet me çmime shumë të ulta dhe jashtë logjikës ekonomike, çka sipas tyre ndikon në cilësinë e ulët të shërbimit apo mallit të blerë.
- Numri i procedurave “Blerje me vlerë të vogël” rezulton i madh për të gjitha bashkitë, por ky numër është veçanërisht i madh në bashkitë Sarandë dhe Berat. Në tre nga katër bashkitë e monitoruara (Fier, Sarandë dhe Berat) konstatohet që për të njëjtin mall apo shërbim të hapet më shumë sesa një procedurë, duke e copëzuar fondin për të respektuar kërkesat për blerje të vogla. Kjo sjellje e AK në disa raste ka qenë e diktuar nga mungesa e likuiditeteve, pasi shlyerja e faturave duhet të bëhet brenda 30 ditëve. Por ka edhe raste kur autoritetet kontraktore prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup.
- Në të gjitha bashkitë konstatohen raste kur një OE shpallet fitues për disa kontrata, por ky fenomen është më i shpeshtë në bashkinë Sarandë. AK ka kontraktuar 3 OE për 25 procedura (respektivisht 10, 9 dhe 6 procedura). Kjo ka ndodhur si për Blerjet me vlerë të vogël ashtu dhe për kontratat për punë.
- Kompanitë e licencuara kanë probleme të Konkurrencës me kompanitë e palicencuara. P.sh në një tender karburanti futen jo vetëm kompanitë që merren me këtë gjë, por ka patur raste që janë futur edhe rrobaqepësi dhe kjo ka penalizuar ofruesit e tjerë të mallit.
- Specializimi i kompanive duhet të mbahet në konsideratë nga ana e AK. Ka raste kur në tendera për detergjentë për kopshtet, marrin pjesë firma ndërtimi. Sipas një OE “firmat e ndërtimit kanë 10 vjet që s’kanë më punë si më parë, e tani futen në çdo tender të mundshëm”.
- E drejta për aplikim në tendera për firma nga e gjithë Shqipëria është pozitive dhe sigurisht i shërben zbatimit të lirive ekonomike, por logjika e biznesit e selekton aplikimin, pasi asnjë firmë nuk i intereson të aplikojë për tender në një zonë shumë larg vendndodhjes së saj sepse transporti i makinerive dhe punonjësve i kushton më shumë. Megjithatë ky kriter penalizon firmat lokale që sipas OE kanë kapacitete shumë të mira për kryerjen e punimeve, edhe me forcë punëtore lokale që do të ndihmonte ekonominë lokale të qytetit.
- Fondi limit i investimit të vendoset me ligj sipas logjikës ekonomike. Çmimi më i ulët nuk duhet të jetë kriter për kualifikim sepse kjo ka ndikuar shumë negativisht në cilësinë e punëve publike dhe ka deformuar konkurrencën.


Grafiku 16: Procedura vs. korrupsion (n=60)

Të intervistuarve i'u kërkua të japin opinionin e tyre në lidhje me ndikimin që kanë patur reformat në fushën e prokurimeve për uljen e korrupsionit. 61% e të intervistuarve mendojnë që procedurat aktuale e kanë ulur disi korrupsionin dhe vetëm 24% mendojnë që ato e kanë ulur dhe e kanë ulur shumë korrupsionin (Grafiku nr. 16).

7.4 APLIKIMI I KRITEREVE TË VEÇANTA

Një pjesë e madhe e të intervistuarve (63%) janë dakord me mendimin që aplikimi i kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, favorizon disa OE dhe diskriminon/përrjashton shumë OE që të marrin pjesë në tender. Më shumë se gjysma e të intervistuarve janë dakord me mendimin që aplikimi i kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, ndikon në uljen e numrit të OE që të marrin pjesë në tender. 27% e tyre janë disi dakord me mendimin që aplikimi i kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, ndikon në uljen e numrit të OE që të marrin pjesë në tender (Grafiku nr. 17).

Grafiku 17: Aplikimi i kritereve të veçanta (N=60)



- Hapësirat që ligji i lë çdo AK të vendosë kritere të veçanta janë të paarsyeshme dhe të padrejta sipas OE. Aplikimi i tyre lë shteg për korrupsion dhe krijon padrejtësi në procedura e kualifikime të OE-ve për punë publike.
- APP duhet të shohë kufizimet për pronësinë e mjeteve. Në tenderat e shpallur specifikohet që mjetet duhet të jenë në pronësi ose me qera. Ky specifikim konsiderohet i padrejtë nga firmat që kanë investuar për vite në blerjen e paisjeve. Sipas tyre është shumë e thjeshtë të bësh kontrata fiktive për qera me firma të tjera që i kanë. Duhet të ketë një limit për marrjen e mjeteve me qera (p.sh kazma, lopata, disa makineri bazë, jo makineritë e tonazhit të rëndë), të paktën 50% e mjeteve të jenë në pronësi, siç ka qenë përpara 2005. Kjo do ndikonte në cilësi, në shtimin e punësimit, si dhe në kryerjen brenda afatit të punëve.
- AK duhet të eliminojnë kriteret e veçanta që janë të ekzagjeruara. Nuk mund t'i kërkohet një firme për rikonstruksion të një shkolle fshati të ketë 240 punonjës, të ketë makineri të tonazhit shumë të rëndë dhe specifikime të tjera.
- Kriteri i garancisë së një tenderi është i përcaktuar me ligj, por komisionet e tenderave vendosin shpesh kritere të pakapshme ose kritere të caktuara sipas kapaciteteve të një firme preferenciale. Sipas OE ka patur disa thirrje për tender në bashkinë Fier ku vetëm emri i firmës mungonte.
- Neni 45 përcakton garancinë në përputhje me vlerën e investimit, ndërkohë që ka raste kur për vlera objekti deri në 100 mln lekë, i kërkohet firmës 300 mln lekë garanci. OE shprehen se kanë ankimuar disa herë këto kritere, kanë ndjekur procedurën e parashikuar dhe kanë fituar; por fatkeqësisht vërehet

se këto raste janë shumë të përsëritura, e jo çdokush ka mundësi dhe durim t'i fillojë e ndjekë deri në fund procedurat e ankimimit.

- Pajisja e firmave me licenca ka krijuar terren për abuzime. Në Sarandë një lloj license disponohet vetëm nga 2 OE. Kur dalin specifkimet dihet se për kë firmë bëhet tenderi që kur shpallet. Kërkesa për vendosjen e kriterit për licenca i diktohet AK nga operatorë të veçantë. Një OE shprehet: “Aplikova për mobilim. Me thanë që duhet licencë për mobilim. Prapë një firmë pa licencë mobilimi e mori. Se si u vendos ata e dinë”.
- Kërkesat për certifikatat ISO janë të padrejta dhe të ekzagjeruara. Këto certifikata sipas OE janë kthyer në biznes. Ka raste që për një punë me vlerë 300,000 lekë kërkohen 3 certifikata ISO për mjedisin. Sipas OE-ve ato nuk tregojnë asnjë cilësi apo kualifikim sepse blihen, bëhen thjesht për të vjelë lekë, ata që i kanë dhe sekserët e tyre.
- Duhet të bëhet një klasifikim i firmave ose të ketë rivlerësim në bazë të kapaciteteve dhe të dihet se për çfarë lloj niveli/punë/tenderi mund të aplikojnë. Siç shprehen disa operatorë ekonomikë “OE mund të mos kenë kapacitet për tendera qindra mijëra euro por për 1 milion lekë kanë mundësi”.
- Sipas OE kriterii pasjes së eksperiencës për punë dhe objekt të ngjashëm brenda një periudhe 3 vjeçare nuk është i drejtë. OE mund të ketë pasur më përpara eksperiencia të ngjashme. Fakti që nuk ka në tre vitet e fundit nuk do të thotë që nuk ka kapacitet ta kryejë atë punë/shërbim. Për më tepër që volumi i punëve ka rënë në këto 3 vite dhe OE lokalë janë më të dëmtuar nga këto kritere.
- Shpesh OE u kërkohet gjatë procesit të tenderimit faturë për vërtetimin e pagesës së dritave. Ka patur OE që janë përjashtuar nga procesi, megjithëse ata pretendojnë se kanë qenë në rregull me detyrimet ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) por bashkia ku ushtronin aktivitetin mund të ketë qenë debitore ndaj saj, gjë që nuk ka fare lidhje me OE.
- Kriteret e veçanta duhet të përpilohen më mirë, më me objektivitet e të lidhura ngushtësisht me natyrën dhe volumin e punëve apo shërbimeve që kërkohen. Ato duhet të përcaktohen me ligj dhe nuk duhet të jenë evazive. Për të kapur kriteret e tenderave OE mbajnë me paga dhe sigurime punëtorë që nuk u duhen dhe si përfundim as në tendera nuk kualifikohen. Kjo i dëmton ata financiarisht dhe rezultojnë me rritje artificiale të numrit të të punësuarve.
- Kërkesa për certifikatat e cilësisë ISO ndaj bizneseve është kërkesë ligjore nga legjislacioni që rregullon PP. Dy vitet e fundit korniza ligjore për PP e ka rritur kërkesën për kapacitete të OE-ve, dhe kjo për biznesin e ndershëm është përkthyer në kosto më të larta. Megjithatë OE mendojnë që këto certifikata nuk garantojnë cilësi për produktin dhe shërbimin. Lëshimi i tyre është kthyer sipas tyre në aferë më vete. Praktikisht OE blejnë ISO pa kriter vetëm se ato kërkohen nga AK. Ashtu si deklaroi një kompani ndërtimi,

pjesë e kampionit, janë të detyruar që nga 2 drejtues teknik punimesh të mbajë deri në 20 të tillë, sepse standardi i ISO e detyron këtë.

7.5 EFEKTIVITETI I PËRDORIMIT TË FONDEVE

- Një nga indikatorët që mat planifikimin dhe menaxhimin e mirë të fondeve është përqindja e kursimit nga fondi limit. Në madhësinë e këtij indikator natyrisht që ndikon vëllimi i prokurimeve që është realizuar në secilën bashki, procedura e prokurimit e realizuar nga bashkia dhe tipi i kontratës. Ky tregues ndryshon sipas bashkive, llojit të procedurës dhe llojit të kontratës.
- Përgjithësisht konstatohet që kursimet e fondit limit si rezultat i prokurimeve në kontratat për punë janë në vlera minimale, madje ka dhe raste kur ato janë nën 1%. Ndërkohë që ka dhe raste sidomos në blerjet e vogla ku nuk kemi fare kursime apo kursimet janë mbi 30%.
- Kursime të mëdha të fondit limit janë konstatuar në kontratat për supervizimin e punëve publike. Pjesa më e madhe e tyre janë jashtë logjikës ekonomike dhe ato nuk mund të shmangen nga AK pasi për to nuk aplikohet vlera anomalisht e ulët.

7.6 FUNKSIONIMI I PORTALIT TË APP

- Sistemi elektronik është shumë i ngadaltë dhe problematik për t'u aksesuar në kohë dhe për të gjetur materialet e dokumente të tjera të nevojshme për PP. SPE ngarkohet shumë sidomos në ditët e fundit të mbylljes së afateve, madje ka raste kur është e pamundur të aksesohet gjë që penalizon OE të interesuar.
- Portali ka vështirësi në përdorim sidomos në ditën e mbylljes së tenderave. Shumë shpesh në orët e fundit para mbylljes së aplikimit ka shumë ngarkesë dhe sistemi bllokohet gjatë aplikimit ose në momentin kur OE janë duke e ruajtur aplikimin në fund të procesit.
- Formularët e aplikimit shpesh herë nuk hapen dhe kjo mund të çojë në probleme sepse afatet mund të mbyllen ndërkohë që OE bllokohen në internet pa mundur të aplikojnë.
- Përpos përpjekjeve për ndryshime në pamjen e faqes së APP ende ka shumë defekte në proces dhe procedura, defekte që shkaktohen dhe lejohen nga hapësirat që le kuadri ligjor që rregullon PP.
- Arkivimi i procedurave në faqe bëhet shumë shpejt dhe është e pamundur të kesh akses në dokumente. Sipas APP, arkivimi i shpejtë bëhet nga APP për të siguruar funksionimin e mirë të sistemit dhe për të mos mbingarkuar serverin. Në këto kushte, AK mund të publikojnë informacion mbi procedurat e prokurimit në faqen e tyre të internetit.

- Sipas AK, numri i kontaktit që APP ka venë në dispozicion për klientët nuk funksionon. Edhe kur përgjigjet dikush, thotë që duhet të bëhet kërkesë me shkrim gjë që do kohë për t'u realizuar e për të marrë përgjigjen.

7.7 MBËSHTETJA E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETET KONTRAKTORE DHE OPERATORËT EKONOMIKË

- Komunikimi me APP për çështje të prokurimit nuk është i kanalizuar saktë. Sipas AK, APP nuk u jep mbështetjen dhe asistencën që ato kanë nevojë dhe presin përmes telefonit dhe aq më pak përmes e-mailit.
- Stafet e bashkive shfrytëzojnë kanalet personale të komunikimit për të marrë informacione nga APP. Njëri prej juristëve të bashkive shprehet "për çdo çështje të ngritur përgjigja është eja në Tiranë".


7.8 SUPERVIZIMI I PUNIMEVE

- AK, por në disa raste dhe OE kanë rezerva të mëdha mbi mënyrën sesi zgjidhen supervizorët e kontratave. Oferta më e ulët, nuk garanton supervizim cilësor dhe të mirëqenë të punimeve.
- Supervizimi duhet të bëhet nga operatorë lokalë, brenda rajonit/qytetit ku zhvillohen punimet sepse ata që vinë nga Tirana në një zonë tjetër të largët nuk mund të mbikëqyrin si duhet punimet, kjo për çështje kohe, kostosh që duhen mbuluar etj. Ka patur dhe opinione që supervizorin duhet ta propozojë AK.
- Mungon në përgjithësi supervizimi i vazhdueshëm dhe kjo çon në punime jo cilësore dhe AK vazhdojnë të kontraktojnë të njëjtat kompani pavarësisht se ato mund të kenë bërë një punë jo të mirë.
- Supervizimi në tendera në përgjithësi është i nënkostuar si për transportin, vlerën e punës, etj. Vlera e supervizimit është shumë më e ulët sesa fondi limit. Kjo lë hapësirë për cilësi shumë të dobët të punimeve, pranohen punë pa cilësi dhe kjo dëmton shërbimin dhe taksapaguesit shqiptarë.

7.9 DISBURSIMI I FONDEVE

Siç paraqitet në Grafikon nr. 18, 73% e të intervistuarve janë dakord me mendimin që detyrimet e papaguara nga Autoriteti Kontraktor ndikojnë në uljen e numrit të OE që marrin pjesë në tender. 40% e operatorëve ekonomikë janë disi dakord me mendimin që procedurat e apelimit/ankimit shoqërohen me kosto të larta për operatorët ekonomikë.

Grafiku 18: Detyrimet e Autoriteteve Kontraktore (N=60)



- AK e kanë disiplinuar çështjen e shpenzimeve për vitin 2014. Megjithatë ka OE që pretendojnë që AK nuk i kanë shlyer detyrimet e viteve të kaluara dhe kjo dëmton aktivitetin normal të tyre. Detyrimet e papaguara kanë qenë një nga arsyet që kanë ulur numrin e OE që marrin pjesë në tendera, sidomos për punë publike. Marzhi i ulët i fitimit dhe koha e disbursimit të fondeve i frenojnë OE që të aplikojnë.
- Procedurat e miratimit të buxhetit nga Këshillat Bashkiakë krijojnë vonesa dhe ndikojnë në afatet e realizimit të punëve publike dhe disbursimin e fondeve për OE. Procedurat e prokurimit për investime fillojnë zakonisht në tremujorin e dytë pasi miratimi i buxheteve ka raste që bëhet në fund të Marsit.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave për shlyerjen e faturave i kushtëzon AK të bëjnë ndarjen e fondit në disa blerje për shpenzimet operative apo investimet që realizohen përmes procedurës "Blerje me vlerë të vogël". Vendosja e afatit një muaj për të paguar faturën nga AK disiplinon financat lokale dhe pengon krijimin e borxheve të reja ndaj OE.
- Megjithatë AK në tremujorin e parë janë përballur me mungesa likuiditeti, pasi ka raste që Drejtoritë Rajonale të Tatim Taksave nuk kanë kaluar të ardhurat nga biznesi i vogël (Bashkia Berat).
- Ndryshimi i kufirit për blerjet e vogla konsiderohet si pozitiv nga AK dhe OE.

7.10 KAPACITETET E AUTORITETEVE KONTRAKTORE DHE OPERATORËVE EKONOMIKË

- Zbatimi i procedurave të prokurimit elektronik paraqet vështirësi për disa AK. Në raste të veçanta kapacitetet e kompjuterave të bashkisë apo edhe shpejtësia e internetit e bëjnë të vështirë dhe ndonjëherë të pamundur aksesin në platformë.
- Njësitë e qeverisjes vendore kanë nevoja të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve për implementimin/monitorim/menaxhimin e këtyre investimeve publike dhe zbatimin korrekt të procedurave të PP.
- Serioziteti i OE që ofertojnë në tenderat për punë e shërbime publike lë për të dëshiruar. Kapacitetet e tyre reale dhe cilësia e shërbimeve është shumë larg asaj që paraqitet në dokumentet kur aplikojnë për punë dhe shërbime publike. Ky fakt bën që punët publike të shtyhen, të shkelen afatet dhe kjo e bën AK subjekt të penaliteteve nga kontrollet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) apo Auditi i investimeve.
- Ofertimi është gjithashtu një çështje që dëmton cilësinë e punëve publike, e cila dëmton qytetarët si taksapagues, por edhe AK. Favorizimi i çmimit më të ulët në një ofertë ka shformuar artificialisht tregun dhe konkurrencën ndërmjet OE, duke ndikuar negativisht në cilësinë e punëve të kryera. Kjo sjellje e një pjese të OE dëmton buxhetin e Bashkisë pasi shumë shpesh bashkive u duhet të paguajnë mbi planin e investimit pasi gjatë rrugës dalin nevoja që nuk mbulohen në ofertimin me çmimin më të ulët.
- Disniveli i ofertave brenda të njëjtës thirrje për punë apo shërbime publike shpesh është shumë i madh. Përfaqësuesit e AK por dhe OE mendojnë që duhet vendosur një nivel dysheme për çmimet e punëve publike, sipas buletinit të çmimeve, vlerës së investimit, kolaudit të punimeve dhe kontrollit të cilësisë së mallit etj. Sistemi duhet forcuar për një kontroll më të fortë aty ku duket se ka abuzime.
- Cilësia e punëve publike dhe shërbimeve të ofruara nga OE duhet të kontrollohet me forma ligjore. Certifikatat e cilësisë ISO nuk justifikojnë realisht cilësinë e punëve, shërbimeve apo mallrave që blihen nga AK.
- Sistemi i supervizimit të punëve publike është defektoz, është si të ligjërosh një marrëdhënie korruptive mes supervizorit dhe OE në kurriz të AK dhe qytetarëve. Duhet parë mundësia që supervizimi të jetë një njësi pranë AK dhe/ose institucioneve të specializuara. Megjithatë, edhe në kushtet aktuale, AK duhet të gjejnë mekanizma të tjerë kontrolli që të sigurojnë realizimin me cilësinë e kërkuar të investimeve. Çështja e supervizimit është problematike për të gjitha AK dhe mund të ketë nevojë për të rishikuar legjislacionin specifik nga institucionet përgjegjëse.



8

KONKLUZIONE

- Ndryshimet e viteve të fundit (2013-2014) për prokurimet publike vlerësohen nga OE si pozitive dhe ndihmuese, por megjithatë OE hasin vështirësi në përdorimin e portalit të prokurimeve, vështirësi që lidhen kryesisht me ngarkesën e madhe në orët e fundit të mbylljes së procedurave, vështirësi në shkarkimin e formularëve apo ngarkimin e dokumenteve të tenderit.
- Informacioni i publikuar në faqen e APP në përgjithësi është i qartë dhe i dedikuar për të gjithë llojet e përdoruesve. Në platformë janë bërë ndryshime të cilat synojnë përmirësimin e shërbimit, lehtësimin e përdorimit dhe rritjen e transparencës. Por megjithatë akoma ka rubrika të cilat duhet të popullohen më mirë nga ana e AK në mënyrë që të rritet aksesimi në informacione më të detajuara në lidhje me rezultatet e tenderave.
- Aplikimi i kriterëve të veçanta nga AK krijon barriera, pengon aksesin e barabartë dhe konkurrencën midis OE. Në raste të caktuara vendosja e këtyre kriterëve favorizon disa OE.
- Në procedurat e monitoruara ka disa raste ekstreme përsa i përket kursimeve nga procedurat e prokurimit. Ka raste kur kursimi është minimal, madje dhe nën 1%, ndërkohë që ka raste sidomos në procedurat e shërbimeve dhe blerjeve të vogla ku kursimi është mbi 30%. Situata të tilla konstatohen në të katër bashkitë e monitoruara.

- Konkurrenca në disa procedura dhe bashki mbetet e ulët. Pjesëmarrja e OE në procedurat e prokurimit publik ndryshon sipas bashkive dhe natyrës së kontratës. Konkurrenca në bashkitë që ndodhen larg qendrave të mëdha është shumë e ulët.
- Përsëritja e disa firmave si fituese më shumë sesa 3 herë gjatë një viti financiar është një indikator që flet për një nivel të ulët konkurrence. Ndërsa rastet me më shumë se 5 herë duhet të jenë objekt auditimi nga institucionet e specializuara.
- Numri i kompanive pjesëmarrëse është i ulët në bashkinë Himarë dhe Sarandë. Ky tregues ka dallime jo vetëm midis bashkive, por dhe midis procedurave që realizohen në të njëjtën bashki.





9

REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme mbështeten në gjetjet e studimit dhe të diskutimeve të realizuara me përfaqësues të AK dhe OE në fokus grupe dhe workshope.

- APP duhet të tërheqë mendimin e grupeve të interesit për ndryshimet dhe/ose përmirësimet që bën në kuadrin ligjor.
- Të përmirësohet kuadri ligjor dhe nënligjor që ka të bëjë me procedurat e kërkesave për sqarime / ankimime e të lehtësohen pengesat që janë konstatuar nga operatorët ekonomikë.
- Të merren masa të mëtejshme, për funksionimin më të mirë të sistemit on-line, në veçanti në drejtim të shpejtësisë dhe aksesit në informacion për publikun e gjerë.
- Për të siguruar një transparencë më të madhe për publikun e në veçanti për OE rekomandojmë që në regjistrin e realizimeve të përfshihet dhe numri i firmave që marrin pjesë në secilën procedurë.
- Për të siguruar cilësi në blerjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe shmangur rastet e abuzimit me çmimin më të ulët duhet të tregohet më shumë vëmendje nga AK e mos aplikohet pranimi i ofertës për vlera anomalisht të ulta.

- APP duhet të ofrojë më shumë asistencë dhe rritje kapacitetesh për AK dhe OE në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë.
- AK duhet të rrisin më tej transparencën me OE dhe publikun në përgjithësi, duke publikuar informacionin mbi PP në faqen e internetit apo në kanale të tjera informimi (parashikimet, realizimet, njoftimet për procedura, njoftimet e fituesve etj).
- AK duhet të bëjnë një shtrirje më të mirë gjatë gjithë vitit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që të rrisin konkurrencën dhe cilësinë e shërbimit të marrë.
- AK duhet të publikojnë kalendarin tentativ të procedurave të prokurimit si dhe regjistrin e realizimeve.
- AK brenda mundësive e ligjshmërisë duhet të shmangin aplikimin e kriterëve të veçanta në një procedurë tenderimi, pasi kjo ndikon në uljen e konkurrencës dhe krijimin e një klime mosbesimi tek OE.



10

REFERENCA

- Agjencia e Prokurimit Publik (2013). Raport Vjetor. I disponueshëm në <https://app.gov.al>. [I aksesuar: 6 maj 2014]
- Agjencia e Prokurimit Publik. Udhëzim Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, udhëzimi nr. 1, datë 28.02.2014 dhe udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015. I disponueshëm në <https://app.gov.al>. [I aksesuar: 9 maj 2014]
- Davila A., M. Gupta, R. Palmer. (2003). Moving procurement systems to the internet: The adoption and use of e-procurement technology models. *European Management Journal*. 21 (1): 11–23. I disponueshëm në: <http://isiarticles.com/bundles/Article/pre/pdf/16855.pdf>. [I aksesuar: 21 prill 2014]
- Ligj Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin Nr.9800 datë 10.09.2007, ligjin Nr. 9855 datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr.10 309, datë 22.07.2010, ligjin nr. 22/2012 dhe ligjin nr. 131/2012 “Për prokurimin publik”. I disponueshëm në <https://app.gov.al>. [I aksesuar: 6 maj 2014]
- OECD (2013), *Principles for Integrity in Public Procurement: Progress in OECD Countries*, OECD Publishing, Paris. I disponueshëm në: <http://www.oecd.org/gov/ethics/48994520.pdf>. [I aksesuar: 10 prill 2014]
- Panayiotou A., P. Gayialis, P. Tatsiopoulos. (2004). An e-procurement system for governmental purchasing. *International Journal of Production Economics*. 90(1): 79–102. I disponueshëm në http://econpapers.repec.org/article/eeeproeco/v_3a90_3ay_3a2004_3ai_3a1_3ap_3a79-102.htm. [I aksesuar: 29 prill 2014]
- Public Procurement European Commission, (2013). I disponueshëm në http://ec.europa.eu/enterprise/policies/innovation/policy/public-procurement/index_en.htm. [I aksesuar: 5 maj 2014]

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM Nr.153, datë 22.03.2007, VKM Nr.135, datë 03.02.2008, VKM Nr.392, datë 08.04.2008, VKM Nr.822, datë 18.06.2008, VKM Nr.46, datë 21.01.2009, VKM Nr.495, datë 15.05.2009, VKM Nr.917, datë 29.7.2009, VKM Nr.398, datë 26.05.2010 dhe VKM Nr.32, datë 23.01.2013. I disponueshëm në <https://app.gov.al>. [I aksesuar: 6 maj 2014]

FAQE INTERNETI

Agjencia e Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>

Banka Botërore: <http://www.worldbank.org>

Bashkia Berat: <http://www.bashkiaberat.gov.al>

Bashkia Fier: <http://www.bashkiafier.gov.al>

Bashkia Himarë: [http:// www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al)

Bashkia Sarandë: <http://www.bashkiasarande.gov.al>

Komisioni i Prokurimit Publik: <http://www.kpp.gov.al>

